

DEKRET
Nr. 5351, datë 11.6.2007

**PËR KRIJIMIN E SEKSIONEVE TË VEÇANTA PENALE PËR GJYKIMIN E TË
MITURVE PRANË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE**

(Ndryshuar me dekretin nr. 5559, datë 27.12.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 13 pika 4 të Kodit të Procedurës Penale, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Të krijohen seksionet e veçanta penale për gjykimin e të miturve, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, si më poshtë:

1. *Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Tiranë, Krujë, Kurbin, Mat, Bulqizë dhe Dibër.*
2. *Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Durrës, Kavajë, Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin.*
3. *Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Shkodër, Lezhë, Mirditë, Malësi e Madhe, Pukë, Tropojë, Kukës dhe Has.*
4. *Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Vlorë, Fier, Mallakastër, Lushnjë, Berat, Skrapar dhe Kuçovë.*
5. *Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Korçë, Pogradec, Kolonjë dhe Devoll.*
6. *Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë, Tepelenë dhe Përmet.*

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi më 1.9.2007.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu